



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Prishtina - Municipality of Prishtina

### EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së dytë të Kuvendit, mbajtur më 10.02.2021, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Drilon Pireva (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Bashkim Beha (PSD), Nol Nushi (PSD), Adrian Berisha (PSD), Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Arbër Vokri (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Naim Hoxha (LVV), Nazlie Bala (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Sami Salihu (LDK), Milazim Vitija (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Florida Canolli (PDK), Suzan Kika, (PDK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Bukurie Canolli (AAK), Fiknete Bejta (Grupi i pavarur), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR), Sami Boroci (AKR), Arbenita Murseli (AKR), Adelina Fazliji (AKR), Granit Shala (Nisma), Valbona Petrovci (e pavarur), Rifat Deri (i pavarur) dhe Sokol Berisha (Grupi i pavarur).

**Munguan:** Migjen Shala (PDK), Visare Gashi (PSD), Vlora Dumoshi (LDK), Naime Osmani (LDK), Egzon Azemi (LVV) dhe Kreshnik Smajlaj (Grupi i pavarur).

**Të pranishëm ishin edhe:** Muhedin Nushi, nënkryetar i Komunës, Selim Pacolli, nënkryetar i Komunës, Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Blerta Basholli, drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës, Adonis Tahiri, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, Gëzim Mehmeti, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Osman Bllaca përfaqësues i ekzekutivit, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të medieve dhe menaxhmenti i "Trafikut Urban".

Mbledhjen e kryesoi **Agim Kuleta**, kryesues i Kuvendit, dhe e hapi diskutimin për rendin e ditës.

**Fiknete Bejta** propozoi që në rend të ditës të futet Propozimvendimi për shtimin e një linje të trafikut urban nga stacioni "Xhamia e Llapit" dhe të përfundojë në stacionin afër doganës në Mutivodë, pra kjo linjë të shtohet për 8 km. Po ashtu, propozoi që Drejtoria e Shërbimeve Publike të organizojë në mënyrë të sigurt dhe me orar të saktë, transportin ditor me minibus 4 herë në ditë për banorët, sidomos për

Faqe 1 nga 12



nxënësit e këtij rajoni dhe fshatrave të tjerë të Gollakut, në dy drejtime, si është nga Dheu i Kuq në Prapashticë deri në Glllogovicë dhe anasjelltas.

**Kryesuesi** tha se në mbledhjen e fundit të KPF-së, u dakordua që pikat e rendit të ditës të mos futen direkt në seancë, sidomos kur kanë implikime buxhetore, pasi që paraprakisht këto duhet të kalojnë përmes KPF-së.

**Agim Gashi** tha se sa i përket propozimit të znj. Bejta, Komuna e Prishtinës e ka Rregulloren e organizmit të linjave të shërbimit në komunën e Prishtinës, e cila është në fuqi. Për të bërë ndryshime të tilla të krijimit të linjave të reja, duhet të sillen rregullorja në Kuvend për ndryshime, zgjerim të rrjetit të shërbimit të udhëtarëve, duke krijuar linja të reja të cilat janë shuar që 20 vjet. Zgjatja e linjës prej pikës së fundit të kthimit të autobusit deri më tutje, e ka në kompetencë Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe nuk ka nevojë të sillen propozimi në Kuvend.

**Vala Peshku** tha se ne gjithmonë kemi reagu, që propozimet të cilat kanë implikime buxhetore nuk mund të sillen aty për aty, 5 minuta para votimit, sepse është totalisht e pa përgjegjshme, sepse jemi duke folur për paranë publike.

**Leutrim Retkoceri** tha se sa i përket propozimit të ngritur për shtimin e linjave të trafikut urban, përderisa Drejtoria e Shërbimeve Publike është kompetente, atëherë ishte dashur që drejtoresha e kësaj drejtorie të na japë ndonjë përgjigje se çfarë ka ndodhur dhe a është në planin e tyre që të shkojë linja deri atje apo jo. Në parim ne do ta pranoni si pikë për diskutim, sepse nuk besojë që ka diçka të keqe nëse trajtohet një problem i qytetarëve.

**Fadil Gashi** tha se grupi parlamentar i AAK-së këto propozime nuk do t'i përkrahë sepse po bëhen për shkak të fushatës. Këto kanë mundur të ngiten edhe më herët, pra ka më shumë se 3 vjet që kurrë nuk janë ngritur këto çështje.

**Sami Boroci** tha se nuk do ta votoj asnjë temë që ka implikime buxhetore dhe nuk mundem si asamblist me e marrë guximin me votuar diçka pa e analizuar pak më shumë, sidomos kur jemi në vit elektoral. Kisha kërkuar me e krijuar këtë praktikë, që asnjë seancë mos me futur pika pa i kaluar procedurat e nevojshme.

**Ardian Berisha** sugjeroi që mos të propozohen pika që ndërlidhen me ndërmarrjet publike "ad-hoc" në këtë mënyrë dhe të cilat kanë implikime financiare. Më mirë do kishte qenë që të krijohet një grupi i përbashkët nga anëtarët e Kuvendit dhe t'i takojmë ndërmarrjet, në mënyrë që të mos kemi probleme të tilla, dhe për këtë çështje u dakordua të gjithë në mbledhjen e fundit.

**Kryesuesi** konstatoi se më 8 vota për, 11 kundër dhe 4 abstenime, nuk u miratua propozimi i znj. Bejta që të hyjë në rend të ditës për diskutim.

**Leutrim Retkoceri** ngriti një shqetësim, duke thënë se disa nga kompanitë private të transportit të udhëtarëve kanë një situatë financiare të rënduar pas krizës së pandemisë, janë kompanitë private me autobusë në linjat e transportit publikë në komunën e Prishtinës. Këto kompani operojnë me 91 autobusë dhe mbulojnë afro 60% të transportit publik në komunën e Prishtinës dhe nuk kanë qenë përfituese as në pakon prej 5 milionë euro dhe as me ndonjë subvencionim për lirimin e transportit pa pagesë për qytetarët e

Prishtinës. Propozoi që të futet në rend dite diskutimi për ndihmën e këtyre kompanive private me autobus në linjat e transportit publik urban në komunën e Prishtinës.

**Halim Halimi** tha se ndaj kompanive private të transportit të udhëtarëve është bërë një diskriminim, e që janë në gjendje të rëndë financiare. E përkrahu propozimin që kjo çështje të hynë në rend të ditës për diskutim.

**Vala Peshku** ngriti një shqetësim, e cila tha se pothuajse shumica e propozimeve të tilla që po na sillen në Kuvend, mendoj se paraqesin një papërgjegjësi, lojë me kategorinë në përfitim qoftë të votave, qoftë për diçka tjetër, sidomos kur jemi në fushatë. Kjo është tepër e evidente edhe është tepër e pasinqertë.

**Mirsad Vitia** tha se e përkrahim pikën e propozuar nga grupi i PDK-së, e për më tepër do të diskutojmë nëse futet në rend të ditës për diskutim.

**Sami Boroci** tha se jam absolutisht kundër që qarkullimin e qytetarëve në trafikun urban me e bërë pa pagesë, sepse kjo ka krijuar tollovia dhe shumëçka tjetër. Kisha propozuar që të formohet një grup punues nga anëtarët e Kuvendit, që ta gjejnë një modalitet dhe ta harmonizojmë këtë ide që në seancën e radhës të sillet si propozim.

**Valbona Ajeti** tha se edhe ne jemi që ky propozim të shtyhet për diskutim për seancën e radhës, pra paraprakisht të kalojë në procedura, sepse edhe ky ka implikime financiare dhe kur të kalon nëpër këto procedura, atëherë na sillet në Kuvend për diskutim.

**Adrian Berisha** tha se është e drejtë e çdo anëtarit të Kuvendit të paraqesë propozime në Kuvend, pavarësisht se a ka apo jo implikime buxhetore. Nuk janë vetëm shoferët e linjave private që kanë probleme financiare në aspektin bizneseve. Ne kemi kategori të ndryshme të cilat ndërlidhen me Komunën e Prishtinës, pra nëse mendojmë me ju ndihmuar grupeve të tilla të cilat janë dëmtuar gjatë kohës së pandemisë, ta krijojmë një grup të përbashkët edhe t'i shohim se cilat janë ato kategori që kanë nevojë për mbështetje financiare.

**Shefki Gashi** ngriti një shqetësim rreth kompanive private të transportit publik të udhëtarëve i cili shtoi se këto kompani që disa vjet janë pa kontratë fare dhe do të ishte shumë e arsyeshme që ne të kërkojmë nga ekzekutivi që pronarët e këtyre bizneseve të legjitimohen dhe të hyjnë në procedura të rregullta bizneseve dhe juridike. Në këtë mënyrë që janë pa kontrata nuk mundem as me e paguar sigurimin e punëtorëve, as sigurimin e vet, nuk mundem me bë shumë e shumë transaksione etj.

**Mimoza Sylejmani** tha se çdo problem që kanë ndërmarrjet publike lokale duhet t'i adresojnë te anëtarët e komisioneve aksionare, pasi që ata janë legjitim dhe janë përgjegjës për inicimin e të gjithave problemeve që t'i paraqesin para Kuvendit.

**Agim Gashi** kërkoi nga të gjithë anëtarët e Kuvendit që për propozimet e tilla të jemi më të përgjegjshëm dhe mos të bëjmë prapë gabime të njëjta, pra t'i analizojmë gjërat dhe t'i krijojmë kushtet për të marrë një vendim të qëndrueshëm edhe financiarisht dhe të përgatitur mirë që nëse dëshirojmë mund ta bëjmë brenda një afati njëjavor.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna rreth propozimit për subvencionimin e kompanive private për transportin publik të udhëtarëve, sqarime të nevojshme dhanë Selim Pacolli, nënkryetar i Kuvendit dhe Valbona Makolli, drejtoreshë.



*Duke pasur parasysh diskutimet, vërejtjet dhe qëndrimet për propozimin: " Diskutim për subvencionimin direkt të kompanive private me autobusë në linjat e transportit publik-urbanë dhe urban-periferik në komunën e Prishtinës", kryesuesi konstatoi se ky propozim shtyhet për diskutim për mbledhjen e radhës së Kuvendit.*

Kryesuesi konstatoi se më 25 vota për, u miratua ky

### **Rend i ditës:**

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
2. Propozimvendimi për donacion të automjeteve të vjetra të Komunës së Prishtinës për nevojat e Qendrës së Trajnimit të FSK-së;
3. Propozimvendimi për miratimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2021;
4. Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit, nr. 01.463/01-139108/20, të dt. 12.08.2020, për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Ismail Shillova, Faik Breznica dhe Osman Breznica;
5. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Besnik Lecit;
6. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Gëzim (Sabri) Thaqit dhe Sevdail (Bajram) Dakut;
7. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Arbër (Ejup) Nezirit, Fatos Nezirit dhe Flamur (Ymer) Nezirit;
8. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Arben Hasanit;
9. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Bejtush Gashit;
10. Informatë lidhur me raportin vjetor të Komisionit të aksionarëve të NPL "Kuzhina Qendrore", SHA, Prishtinë;
11. Informatë lidhur me raportin vjetor të Komisionit të Aksionarëve të NPL "Trafiku Urban", SHA, Prishtinë;
12. Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit, nr. 01-030/01-0210515/20, dt. 13.11.2020, për caktimin e kompensimit për anëtarë të komisioneve të aksionarëve të NPL-ve;
13. Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2020 (TM 4);
14. Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2020;

15. Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit, nr. 01-020/04-15223/18, të dt. 18.01.2018, për caktimin e anëtarëve në komisionet e aksionarëve të ndërmarrjeve publike të Komunës së Prishtinës;
16. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e pllakës përkujtimore me rastin e përvjetorit të demonstratave të 11 marsit të vitit 1981;
17. Propozimvendimi për ndalimin e ndërtimeve në gjithë zonën e Peizazhit të mbrojtur të Gërmisë, deri në miratimin e Planit menaxhues të parkut;
18. Pyetje dhe përgjigje;
19. Të ndryshme.

#### Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Kryesuesi konstatoi se prezent në sallë janë 36 anëtarë të Kuvendit dhe më 24 vota për dhe 1 abstenim, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së parë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

#### Pika e dytë

Propozimvendimi për donacion të automjeteve të vjetra të Komunës së Prishtinës për nevojat e Qendrës së Trajnimit të FSK-së.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri më 37 vota për, u miratua vendimi për donacion të automjeteve të vjetra të Komunës së Prishtinës për nevojat e Qendrës së Trajnimit të FSK-së.

#### Pika e tretë

Propozimvendimi për miratimin e planit vjetorë të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2021.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 35 vota për, u miratua vendimi për miratimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2021.

#### Pika e katërt

Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit, nr.01.463/01-139108/20, të dt.12.08.2020, për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Ismail Shillova, Faik Breznica dhe Osman Breznica.

Leonora Shabani - Bajraktari tha se përderisa në mbledhje të Kuvendit mungon drejtori i Drejtorisë së Pronës, pikat të cilat kanë të bëjnë me këmbim të pronave, grupi parlamentar i LVV- së nuk do ti voton.

Kryesuesi konstatoi se më 29 vota për dhe 1 abstenim, u miratua vendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit, nr.01.463/01-139108/20, të dt.12.08.2020, për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Ismail Shillova, Faik Breznica dhe Osman Breznica.

**Pika e pestë**

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Besnik Lecit.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 29 vota për, u miratua vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Besnik Lecit.

**Pika e gjashtë**

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Gëzim (Sabri) Thaqit dhe Sevdali (Bajram) Dakut.

Kryesuesi konstatoi se më 25 vota për dhe 2 abstenime, u miratua vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Gëzim (Sabri) Thaqit dhe Sevdali (Bajram) Dakut.

**Pika e shtatë**

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Arbër (Ejup) Nezirit, Fatos Nezirit dhe Flamur (Ymer) Nezirit.

Kryesuesi konstatoi se më 25 vota për dhe 2 abstenime, u miratua vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Arbër (Ejup) Nezirit, Fatos Nezirit dhe Flamur (Ymer) Nezirit.

**Pika e tetë**

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Arben Hasanit.

Kryesuesi konstatoi se më 25 vota për dhe 2 abstenime, u miratua vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Arben Hasanit.

**Pika e nëntë**

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Bejtush Gashit.



Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për dhe 1 abstenim, u miratua vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Bejtush Gashit.

**Pika e dhjetë**

**Informatë lidhur me raportin vjetor të Komisionit të aksionarëve të NPL "Kuzhina Qendrore", SHA, Prishtinë.**

**Fiknete Bejta** tha se me një vendim të veçantë të Kuvendit komunal "Kuzhina Qendrore" është krijuar si ndërmarrje publike lokale. Kjo ndërmarrje deri më tani ka qenë si ndërmarrje edhe me resurse njerëzore, financiare edhe logjistike nën menaxhimin e Komunës së Prishtinës. Në tetor aksionarët kanë organizuar konkurs publik, kanë zgjedhur Bordin drejtues, një Bord të paanshëm politikisht dhe sot ndërmarrja është e kompletuar në aspektin e Bordit dhe menaxhmentit.

Si strukturë dhe bazament i "Kuzhinës Qendrore" dhe në aspektin e funksionalizimit ushtruesi i detyrës së bashku me Bordin, kanë miratuar Planin e biznesit për vitin 2020, plan i cili është ambicioz dhe ka rezultate të arritshme. Janë nxjerrë rregulloret për punën e komiteteve të Bordit të drejtorëve, Rregulloret e marrëdhënies së punës dhe procedurës disiplinore të ndërmarrjes, Rregullorja për orarin e punës, Rregullorja për arkën, Rregulloren për afatet dhe kompensimet e tjera të Kuzhinës Qendrore, udhëzimin, përkrahimin si dhe sistematizimin e vendeve të punës, si dhe është ndërtuar një organogram që i përmbush kërkesat dhe organizimin e Kuzhinës Qendrore.

**Halim Halimi** tha se sa i përket këtij raporti që na u prezantua, nga aspekti financiar munguan shumë të dhëna, kështu që si informatë ne e përkrahim me dëshirën që në të ardhmen kjo ndërmarrje të ketë një sukses pozitiv.

**Naim Hoxha** tha se ky raport është dashtë që ta ketë njëfarë doze të një informimi, me treguar se sa ka qenë aktiviteti i kësaj kuzhine gjatë vitit të kaluar, sa shujta i ka punuar, sa klientë kanë qenë aty, cilat shërbime i ka bërë. A nënkupton që Kuzhina do ti furnizojë edhe shkollat me ushqime të ndryshme apo thjesht një aktivitet i cili më shumë i ngjan një raporti të këtij drejtori i cili është caktuar aty si zgjidhje e përkohshme se sa të aksionarëve tonë.

Aksionarët duhet me na informuar se çka ka bërë kjo kuzhinë, prandaj mendoj se nuk duhet ta aprovojme si të tillë, por ta shtyjme që ta bëjnë një raport më serioz dhe më konciz.

**Muhamet Selmani** ngriti një shqetësim rreth funksionalizimit të kësaj ndërmarrjeje, duke thënë se si guxojmë ne me ia lejuar vetes me e krijuar një ndërmarrje që ka me operuar me humbje të vazhdueshme, e ne me paguar rroga shtesë për të punësuar aty.

Gjenerimi i profitit në ndërmarrje publike është elementi kryesor kur themelohet, nëse e ke themeluar një ndërmarrje publike ajo e ka bazë profitin nuk ka tjetër.

Do të ishte mirë që të shihet mundësia që ky Kuvend ta formoj një grup punues, që kanë me bërë fuzionimin e këtyre ndërmarrjeve një ndërmarrje të vetme, e që do të reduktoheshin këto shpenzime.

**Leutrim Retkoceri** ngriti një shqetësim, duke thënë se nëse një ndërmarrje është nisur me qëllim të mirë para dy viteve dhe ende nuk e ka funksionalizimin ose funksionimin, edhe kjo është një çështje që duhet me u trajtuar.

Faqe7nga12

Mund të themi se në secilën ndërmarrje kontratat mbi vepër ose të punëtorëve që lihen mbi gjashtë muaj, që janë edhe vërejtje të auditorit, janë shqetësime serioze, që do duhej paraqiteshin edhe nga aksionarët të cilët i kemi në Kuvend.

**Drilon Pireva** tha se qëllimi i themelimit të këtyre ndërmarrjeve është se e rrisin vlerën shoqërore, andaj nuk duhet shikuar vetëm profitin e tyre dhe unë këtu shoh dallime ideologjike.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna rreth këtij raporti, sqarime shtesë dha Valbona Makolli, drejtoreshë.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Informata lidhur me raportin vjetor të Komisionit të aksionarëve të NPL "Kuzhina Qendrore", SHA, Prishtinë.**

**Pika e njëmbëdhjetë**

**Informatë lidhur me raportin vjetor të Komisionit të Aksionarëve të NPL "Trafiku Urban", SHA, Prishtinë.**

**Adrian Berisha**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit komunal të aksionarëve të kësaj ndërmarrje në pika të shkurtra i njoftoi të pranishmit duke cekur se Trafiku Urban operon në Komunën e Prishtinës me 51 autobus në total, dhe në shtatë linja. Trafiku Urban ka kontratë për shërbim publik me Komunën e Prishtinës, por për shkak të pandemisë kemi pasur probleme të ndryshme financiare.

Me planifikimin e të hyrave dhe të hyrat që i kemi pasur si Trafik Urban, ne kemi arritur me i realizuar vetëm 84%.

Po ashtu vlen të ceket që jemi në negociim me BERZH për blerjen e autobusëve të ri, ku do të fokusohemi që në të ardhmen të kemi edhe autobus elektrik.

**Agim Gashi** tha se pa dyshim që kjo ndërmarrje duhet të jetë rentabile, sepse burimet i ka të sigurta, dhe nuk mund të jetë jo rentabile në çoftë se së paku menaxhmenti i kryen obligimet e veta ligjore, duke marrë parasysh teknologjinë e re, kushtet më të mira, burimet financiare të sigurta dhe aty duhet të ketë rentabilitet, dhe kjo ndërmarrje duhet të menaxhohet sa më mirë që është e mundshme. Sa i përket shtimit të linjave të reja, mendoj se nuk ka pengesa financiare nga ajo që tha drejtoresha, por besoj se vet ndërmarrja e ka fuqinë financiare dhe ekonomike ta përballojë atë kosto, pa ndonjë ndryshim esencial.

**Leonora Shabani - Bajraktari** tha se kjo është e vetmja ndërmarrje që ka bërë ndryshime në shoqëri, për herë të parë ne kemi parë gra shofere, gra konduktore të autobusëve, gjithashtu ka bërë ndryshime edhe sa i përket kategorisë me aftësisë së kufizuara, ku ka punësuar persona me aftësi të kufizuara dhe pa dyshim ne e përkrahim këtë raport.

**Leutrim Retkoceri** tha se sa i përket Trafikut Urban dhe performancës, është shumë interesant nëse merren dhe shikohen dokumentacionet e plota si për marrjen e kredisë që ka aplikuar Komuna për Trafikun Urban në BERZH, edhe disa kriteret e cilat mbeten ende të paplotësuar.



Po ashtu, Trafiku Urban ja qet Komunës së Prishtinës një barrë bukur të madhe që e ke edhe në raport, po besoj se kjo është reale, që për një vjet 4 milionë e 230 mijë euro është fatura e Komunës së Prishtinës që e paguan për Trafikun Urban, edhe kjo është jashtëzakonisht shqetësuese. Po ashtu, konsideroj si shqetësuese edhe disa punëtorë që janë me kontratë mbi vepër, e të cilët e kalojnë afatin e paraparë ligjor, që është dy herë nga gjashtë muaj. Dua të dije se marrja e këtyre punëtorëve me kontratë mbi vepër a ka qenë nevojë, apo më shumë ka qenë qëllim i ndonjë personi që të sistemojë disa njerëz nëpër vende të punës.

**Rifat Deri** kërkoi të dije se menaxhmenti i kësaj ndërmarrjeje si ka planifikuar me blerë autobusë të rinj dhe prej atyre sa do të jenë eko- autobusë dhe a pritet që në të ardhmen të zgjerohet rrjeti i linjave për të gjitha fshatrat e komunës së Prishtinës, apo do të mbesin edhe më tutje në përgjegjësi të kompanive private.

**Valbona Ajeti** tha se edhe ne si grup parlamentar e përkrahim këtë raport, i cili është mjaft i detajuar, dhe i bashkëngjitem falënderimit të Leonorës për punësimin e grave në këtë ndërmarrje.

**Vala Peshku** tha se në Trafikun Urban përveç autobusëve të rinj, të inkorporohen edhe autobusët e operatorëve privatë, por duke pasur parasysh plotësimin e disa kushteve teknike çoftë në ato ambientaliste, çoftë edhe të pamjes dhe të pastërtisë brenda autobusit. Lidhur me këtë çështje, kërkoi nga anëtari i komisionit një informatë.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime shtesë dhanë Adrian Berisha dhe Genc Bashota, drejtor.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Informata lidhur me raportin vjetor të Komisionit të Aksionarëve të NPL "Trafiku Urban", SHA, Prishtinë.**

*Mimoza Sylejmani i uroi Blerta Bashollit, drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës, për marrjen e tri çmimeve kryesore që iu ndan në festivalin më të rëndësishëm të filmit në Amerikë. Këtij urimi iu bashkëngjiten të gjithë të pranishmit në sallë.*

**Pika e dymbëdhjetë**

**Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit, nr. 01-030/01 - 0210515/20, të dt. 13.11.2020, për caktimin e kompensimit për anëtarët e komisioneve të aksionarëve të NPL-ve.**

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 35 vota për, u miratua Vendimi për plotësim - ndryshimin e Vendimit, nr. 01-030/01 - 0210515/20, të dt.13.11.2020, për caktimin e kompensimit për anëtarët e komisioneve të aksionarëve të NPL-ve.**

**Pika e trembëdhjetë**

**Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2020 (TM4).**

Kryesuesi konstatoi se njëzëri më 35 vota për, u miratua Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 tetor- 31 dhjetor 2020(TM4).

**Pika e katërmbëdhjetë**

**Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 Janar - 31 Dhjetor 2020**

Kryesuesi konstatoi se njëzëri më 28 vota për, u miratua Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 Janar - 31 Dhjetor 2020.

**Pika e pesëmbëdhjetë**

**Propozimvendimi për plotësim - ndryshimin e vendimit, nr.01-020/04-15223/18, të dt. 18.01.2018, për caktimin e anëtarëve në komisionet e aksionarëve të ndërmarrjeve publike të Komunës së Prishtinës**

Halim Halimi, për anëtar të Komisionit të aksionarëve në KR "Pastrimi", propozoi Jeta Rafunën.

Vala Peshku, për anëtar të komisionit të aksionarëve në KR "Pastrimi", propozoi Sami Borocin.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri me 31 vota për, u miratua propozimi, që Jeta Rafuna të caktohet anëtare e Komisionit komunal të aksionarëve në KR "Pastrimi".

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 31 vota për, u miratua propozimi që Sami Boroci të caktohet anëtar i Komisionit komunal të aksionarëve në KR "Pastrimi".

Vala Peshku, për anëtar të Komisionit të aksionarëve në NP "Prishtina Parking", propozoi Qëndrim Sahitin.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 31 vota për, u miratua propozimi që Qëndrim Sahiti të caktohet anëtar i komisionit në NP "Prishtina Parking".

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 31 vota për, u miratua Vendimi për plotësim - ndryshimin e Vendimit, nr. 01-020/04-15223/18, të dt. 18.01.2018, për caktimin e anëtarëve në komisionet e aksionarëve të ndërmarrjeve publike të Komunës së Prishtinës.

**Pika e gjashtëmbëdhjetë**

**Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e pllakës përkujtimore me rastin e përvjetorit të demonstratave të 11 marsit të vitit 1981.**

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 36 vota për, u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e pllakës përkujtimore me rastin e përvjetorit të demonstratave të 11 marsit të vitit 1981.



## **Pika e shtatëmbëdhjetë**

**Propozimvendimi për ndalimin e ndërtimeve në gjithë zonën e Peizazhit të mbrojtur të Gërmisë, deri në miratimin e Planit menaxhues të parkut.**

**Agim Gashi** tha se ndalimi i ndërtimit në zonën e parkut është e rregulluar me Planin zhvillimor komunal dhe me aktet tjera të miratuara në këtë Kuvend, kështu që nuk e shoh të nevojshëm të marrim një vendim ekstra, sepse ajo është e rregulluar.

**Leonora Shabani – Bajraktari** tha se sa i përket kësaj teme përveç neve, do të ishte mirë që të ishin pjesëmarrës edhe organizatat e shoqërisë civile, sepse ne kemi presion nga ato organizata dhe me këtë çështje besoj se janë të njoftuar të gjithë anëtarët e Kuvendit.

Ne si LVV nuk jemi kundër parkut, por jemi kundër hapësirës, pse të ndërtohet në Gërmi, pra do të ishte mirë që të ndërtohet diku në periferi të qytetit, në ndonjë zonë rurale.

**Suzan Kika** tha se klasifikimi i zonave të mbrojtura me Ligjin për mbrojtjen e natyrës është në harmoni me Unionin Botëror për Ruajtjen e Natyrës, dhe zonat e mbrojtura klasifikohen në shtatë kategori, e Gërmia klasifikohet tek peizazhet e mbrojtura.

Në peizazhet e mbrojtura nuk lejohet ndërhyrje dhe punët të cilat prishin karakteristikat për shkak të cilit është shpallur i mbrojtur, andaj nuk shoh ndonjë arsye që t'i ndalojmë këto aktivitete për fëmijë nëse nuk është në kundërshtim me ligjin.

Lidhur me Propozimvendimin për ndalimin e ndërtimeve në gjithë zonën e Peizazhit të mbrojtur të Gërmisë, deri në miratimin e Planit menaxhues të parkut, në pika të shkurtra të pranishmit i informoi **Blerta Basholli**, drejtoreshë.

**Kryesuesi** tha se u dhanë sqarime të mjaftueshme, përndryshe nëse është e arsyeshme, sqarime të nevojshme mund të japë edhe drejtoresha e Swis-Kontaktit, e cila është këtu prezente, prandaj propozimi është për ndalimin e ndërtimeve për gjithë zonën e Peizazhit të Gërmisë deri në miratimin e Planit menaxhues të parkut.

**Kryesuesi** konstatoi se 2 vota për, janë që të ndalohen ndërtimet në gjithë zonën e Peizazhit të mbrojtur të Gërmisë, kurse 31 janë kundër, që të mos ndalohen ndërtimet në këtë zonë deri në miratimin e Planit menaxhues të parkut.

**Kryesuesi** konstatoi se më 31 vota kundër dhe 2 vota për, nuk u miratua Propozimvendimi për ndalimin e ndërtimeve në gjithë zonën e Peizazhit të mbrojtur të Gërmisë, deri në miratimin e Planit menaxhues të parkut.

## **Pika e tetëmbëdhjetë Pyetje dhe përgjigje**

**Naim Hoxha, për kryetarin e Komunës:**

- Para një apo dy jave ndërmarrja e ujit ka pasur problem me ndotjen e ujit dhe ka pasur mungesë të ujit në qytetin e Prishtinës, andaj dhe pyes: Çka ka qenë arsyeja e asaj ndotjeje, sepse ka vërejtje se projekti përkatës i ujit nuk është përfunduar deri në fund, dhe marrja e ujit prej sistemit të ujit është duke u bërë me hapësira të hapura.

Faqel 1 nga 12

**Mirsad Vitia, për drejtoreshën e Drejtorisë së Financave :**

- A ka filluar të bëhet subvencionimi i bizneseve në territorin e Komunën e Prishtinës, pasi që disa nga ato biznese kanë pakënaqësi ose nuk është përgjigjur Komuna ndaj nevojave të tyre.

**Valbona Makolli, drejtoreshë,** tha se ne kemi filluar në fund të vitit me i bërë ndarjen e këtyre subvencioneve, disa kemi arritur me i proceduar, mirëpo më shumë se 2 milion euro, nuk janë kryer pagesat për shkak të mungesës së masës monetare, edhe janë shpërndarë vetëm 725 mijë e 500 euro. Kanë mbetur edhe 4 mijë e 279 biznese me 4 milion e 274 e 500 euro pa u shpërndarë, ato janë krejt të gatshme vetëm mungon masa monetare.

Ne kemi filluar me e bërë bartjen e mjeteve dhe shumë shpejt do ta thërrasim një mbledhje të jashtëzakonshme, sepse këta njerëz e kërkojnë të drejtën e tyre.

**Kushtrim Sopa, pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale:**

- Pse nuk është ndërmarrë asgjë përveç matjeve, për shtëpinë e djegur të z. Ekrem Dobratiqi në Lebanë, Komuna e Prishtinës, ku kanë kaluar më shumë se 1 vjet dhe ai jeton në gjendje tejet të rëndë?

**Për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave:**

- Pse nuk po vazhdohet puna në rrugën "Azem Sopi" në fshatin Butoc, ku janë kryer dhe asfaltuar 600 metra rruge, por rruga për 2 km, ka mbetur në gjysmë e që banorët janë në hall, gjithashtu edhe pronarët e tokave në atë pjesë të qytetit?
- Çfarë po bëhet me ndërtimin e rrugës "A" në lagjen "Emshiri", ku është punuar kolektori që vazhdon për Uglar?
- Gjendja e rrugëve në qytet është pothuajse kaotike, nga gropa dhe prerjet e rrugëve mbushjet me zhavorr. Kur do të filloj riparimi i tyre dhe shtrimi me asfalt?

**Për drejtoren e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:**

- Po bëhen gati 6 muaj pa ndriçim publik në shumë rrugë të qytetit dhe fshatrave të Prishtinës, andaj a do të përmirësohet kjo gjendje?
- Në rrugën përball fabrikës "Vjosa" në fshatin Llukar nuk ka ndriçim, është e vetmja rrugë e cila nuk ka ndriçim në këtë pjesë, andaj a do të ndërmerret ndonjë hap në këtë drejtim?

Mbledhja përfundoi në orën 12:45.

Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit  
Agim Kuleta



Faqe 12 nga 12